



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 26 gusht 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F00854

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HISTORIKU PROCEDURAL	2
II. PARASHTRIMET.....	4
A. Mbrojtja e Thaçit.....	4
B. Mbrojtja e Selimit.....	6
C. Mbrojtja e Krasniqit	7
D. Mbrojtja e Veselit.....	8
E. ZPS.....	9
III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	9
IV. DISKUTIM	10
A. Standardi ligjor	10
B. Pikat për të cilat miratohet leja për apel	11
1. Pika e Dytë e Thaçit, Pika e Pestë e Krasniqit dhe Pika e Parë e Veselit.....	11
2. Pika e Gjashtë e Krasniqit.....	14
3. Pika e Katërt e Thaçit, Pika e Tretë e Krasniqit dhe Pika e Parë e Selimit	16
4. Pika e Parë e Thaçit.....	20
5. Pika e Katërt e Selimit dhe Pika e Tetë e Thaçit.....	22
C. Pikat për të cilat refuzohet leja për apel.....	24
1. Pika e Tretë e Thaçit	24
2. Pika e Pestë dhe Pika e Gjashtë e Thaçit.....	26
3. Pika e Shtatë, e Nëntë dhe e Njëmbëdhjetë e Thaçit dhe Pika e Tretë e Selimit	28
4. Pika e Dhjetë e Thaçit	33
5. Pika e Dymbëdhjetë dhe Pika e Trembëdhjetë e Thaçit	34
6. Pika e Katërmëdhjetë e Thaçit.....	36
7. Pika e Pesëmbëdhjetë e Thaçit.....	38
8. Pika e Dytë e Selimit	39
9. Pika e Parë dhe Pika e Dytë e Krasniqit.....	40
10. Pika e Katërt e Krasniqit.....	42
11. Pika e Dytë e Veselit.....	44
12. Pika e Tretë e Veselit	45
V. VENDIM.....	47

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 qershor 2022, me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) për një protokoll për trajtimin e informacionit konfidencial dhe kontakteve me dëshmitarë,² Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi (“Vendimi i Kundërshtuar” dhe “Korniza”).³

2. Më 1 korrik 2022, me kërkesë të përbashkët të Mbrojtjes së Hashim Thaçit (“z. Thaçi” dhe “Mbrojtja e Thaçit”), Kadri Veselit (“z. Veseli” dhe “Mbrojtja e Veselit”), Rexhep Selimit (“z. Selimi” dhe “Mbrojtja e Selimit”) dhe Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi” dhe “Mbrojtja e Krasniqit”, bashkërisht “të Akuzuarit” dhe “Mbrojtja”) për zgjatje të afatit për dorëzimin e kërkesës për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar,⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshoi afatin dhe vendosi ta merrte vendimin ditën e premte, 26 gusht 2022.⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00594, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë*, 3 dhjetor 2021, publike, para. 1, 7.

³ KSC-BC-2020-06, F00854, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi*, 24 qershor 2022, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00857, Mbrojtja, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00854 (Vendimi për Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë)*, 29 qershor 2022, publike, para. 1, 7.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00864, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00854 (Vendimi për Informacionin Konfidencial dhe Kontaktet me Dëshmitarë)*, 1 korrik 2022, publik, para. 9-11.

3. Më 18 korrik 2022, Mbrojtja kërkoi leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar (bashkërisht “Kërkesat e Mbrojtjes”).⁶
4. Më 1 gusht 2022, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesave të Mbrojtjes (bashkërisht “Përgjigjet e ZPS-së”).⁷
5. Më 15 gusht 2022, Mbrojtja iu kundërpërgjigj Përgjigjeve të ZPS-së.⁸

⁶ KSC-BC-2020-06, F00883, Mbrojtja, Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi (“Kërkesa e Thaçit”), 18 korrik 2022, publike; F00884, Mbrojtja, Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi (“Kërkesa e Selimit”), 18 korrik 2022, publike; F00886, Mbrojtja, Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi (“Kërkesa e Krasniqit”), 18 korrik 2022, publike; F00887/COR, Mbrojtja, Version i Korrigjuar i Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarët (F00854) (“Kërkesa e Veselit”), 19 korrik 2022, publike, me Shtojcën 1, publike. Kërkesa origjinale e Veselit u dorëzua brenda afatit më 18 korrik 2022.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00903, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (“Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit”), 1 gusht 2022, publike; F00904, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (“Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit”), 1 gusht 2022, publike; F00905, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (“Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit”), 1 gusht 2022, publike; F00906, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (“Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit”), 1 gusht 2022, publike.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00924, Mbrojtja, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (F00905) (“Kundërpërgjigjja e Thaçit”), 15 gusht 2022, publike; F00925, Mbrojtja, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (“Kundërpërgjigjja e Krasniqit”), 15 gusht 2022, publike, me Shtojcën 1, publike; F00926, Mbrojtja, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes së ZPS-së ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (“Kundërpërgjigjja e Selimit”), 15 gusht 2022, publike; F00927, Mbrojtja, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës për Leje për Apelim të Vendimit F00854 (F00906) (“Kundërpërgjigjja e Veselit”), 15 gusht 2022, publike.

II. PARASHTRIMET

A. MBROJTJA E THAÇIT

6. Mbrojtja e Thaçit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar lidhur me 15 pikat e mëposhtme:

- (1) Nëse incizimi dhe nxjerrja e intervistave të dëshmitarëve përbën ndërhyrje të gabuar në konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient dhe nëse komprometon të drejtën e të akuzuarit për të hetuar provat kundër tij ("Pika e Parë e Thaçit");
- (2) Nëse [Korniza] dhe masat e saj përfshihen në [...] objektin e kompetencës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake që ia jep neni 39(11) [i Ligjit] për të siguruar "kur është e nevojshme" privatësinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve ("Pika e Dytë e Thaçit");
- (3) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar kur nuk mori në shqyrtim Parashtrimet Shtesë të Thaçit, duke pasur parasysh relevancën për pikat në shqyrtim të praktikës së përfshirjes nga ZPS-ja të njerëzve në Listën e Dëshmitarëve të saj pa dijeninë dhe/ose pëlqimin e tyre ("Pika e Tretë e Thaçit");
- (4) Nëse fushëveprimi dhe kushtet e nenit 39(11) [të Ligjit] kërkonin që Gjykatësi së Procedurës Paraprake të bënte dallimin midis kategorive të dëshmitarëve të ZPS-së në zbatimin [e Kornizës] ("Pika e Katërt e Thaçit");
- (5) Nëse urdhërimi i incizimit dhe nxjerrjes së intervistave të Mbrojtjes në bazë të "atmosferës së frikësimit të dëshmitareve dhe ndërhyrjes" dhe "ndikimit të konsiderueshëm" të vazhduar të të akuzuarve shkel prezumimin që Mbrojtja do të veprojë në mirëbesim ("Pika e Pestë e Thaçit");
- (6) Nëse mbështetja në "rreziqet e vërtetuara të nxjerrjes së informacionit për Mbrojtjen" krijon një standard të dyfishtë të gabuar, në të cilin Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka pranuar që ZPS-ja vepron në mirëbesim dhe ka konstatuar se "çdo sugjerim mbi sjellje apo motive të papërshtatshme nga ana e ZPS-së janë të pabazuara dhe spekulative" ("Pika e Gjashtë e Thaçit");

- (7) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka përdorur në mënyrë të gabuar një përkufizim të ngushtë të “detyrimit” kur ka konstatuar se, ngaqë “Mbrojtja është e lirë ta përcaktojë strategjinë e vet” gjatë intervistave me dëshmitarët e ZPS-së, informacioni i zbuluar gjatë intervistave të Mbrojtjes nuk është marrë me detyrim (“Pika e Shtatë e Thaçit”);
- (8) Nëse kërkesa që Mbrojtja të nxjerrë incizimet audio-video të intervistave të saj është në përputhje me praktikën e paraparë në rregullat 104-111 të Rregullores (“Pika e Tetë e Thaçit”);
- (9) Nëse mbështetja e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në faktin se incizimet e intervistave nuk bëhen automatikisht pjesë e dokumentacionit të çështjes nuk merr në konsideratë ose nuk i mendon të rëndësishme parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me rreziqet e tjera praktike për të akuzuarit, përfshirë krijimin e një dokumentacioni të pafavorshëm dhe zbulimin pistave hetimore të cilat ndihmojnë ZPS-në (“Pika e Nëntë e Thaçit”);
- (10) Nëse ngritja e çështjes së privatësisë së dëshmitarëve nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake tërësisht në lidhje me dëshmitarët e ZPS-së, pa iu referuar të drejtave apo pritjeve të dëshmitarëve të Mbrojtjes, e bën të domosdoshëm anulimin e të gjitha konstatimeve të mbështetura në këtë arsyetim (“Pika e Dhjetë e Thaçit”);
- (11) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar kur është mbështetur në pritjen për privatësi të dëshmitarëve të ZPS-së për të kërkuar incizimin dhe nxjerrjen e intervistave të Mbrojtjes, në mungesë të ndonjë lidhjeje të konstatuar midis privatësisë së dëshmitarëve të ZPS-së dhe kësaj mase, apo të ndonjë arsyetimi se si po cenohen, po balancohen apo po merren në konsideratë të drejtat e të akuzuarve (“Pika e Njëmbëdhjetë e Thaçit”);
- (12) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka pasur ligjërisht të drejtë të konstatonte se [Korniza] zbatohet njësoj për ZPS-në dhe për Mbrojtjen, kur të gjitha intervistat e ZPS-së para 24 qershorit 2022 janë kryer në mungesë të Mbrojtjes, në kundërshtim me kornizën procedurale në Kosovë e cila parasheh

pjesëmarrjen e Mbrojtjes në hetimet e prokurorisë (“Pika e Dymbëdhjetë e Thaçit”);

- (13) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar me konstatimin se Mbrojtja nuk ka të drejtë të jetë e pranishme gjatë intervistave të [Task Forcës Hetimore Speciale dhe] ZPS-së sepse kishin të bënin me “raportin e Këshillit të Evropës në tërësi”, duke pasur parasysh hetimet më të vonshme të lidhura me çështjen për vetë z. Thaçi (“Pika e Trembëdhjetë e Thaçit”);
- (14) Nëse përfundimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se [Korniza] “kontribuon në kryerjen e shpejtë të procesit” është shqyrtuar nga një gjykues i arsyeshëm faktesh (“Pika e Katërbëdhjetë e Thaçit”); dhe
- (15) Nëse pasojat për të drejtën e të akuzuarve që të kenë kohë dhe mjete të mjaftueshme në bazë të nenit 21(4)(c) të Ligjit mund të konsiderohen të shtuara me masa të tilla si intervista të përbashkëta të Mbrojtjes me dëshmitarët e ZPS-së ose intervista në distancë me dëshmitarët e ZPS-së, në një kohë kur nuk janë marrë në konsideratë kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj këtyre masave (“Pika e Pesëmbëdhjetë e Thaçit”).⁹

B. MBROJTJA E SELIMIT

7. Mbrojtja e Selimit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar lidhur me 4 pikat e mëposhtme:

- (1) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar me konstatimin se nenet 35(2)(f), 39(1) dhe (11) [të Ligjit] parashohin bazë ligjore për [...] Kornizën e cila nuk kërkon që secili dëshmitar ta përligjë zbatimin e saj sipas rrethanave individuale (“Pika e Parë e Selimit”);
- (2) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë gabim faktik kishte paraparë, sipas mendimit të tij, “garanci” kompensuese lidhur me objektin e [...]

⁹ Kërkesa e Thaçit, para. 6; shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 9.

zbatimit të Kornizës, konkretisht rishikimin gjyqësor të preferencave të dëshmitarit ("Pika e Dytë e Selimit");

- (3) Nëse pika II.n.ii. dhe o. e [...] Kornizës, lidhur me dorëzimin e detyrueshëm të paneli dhe pala kundërshtare të incizimeve zanore dhe me video të intervistave me dëshmitarët dhe me mundësinë për t'u përfshirë në dokumentacion, tejkalon funksionet e Gjykatës të Procedurës Paraprake të parapara në nenin 39(11) [të Ligjit] ("Pika e Tretë e Selimit"); dhe
- (4) Nëse dispozitat e pikës II.n.ii. dhe o. të [...] Kornizës, lidhur me dorëzimin e detyrueshëm panelit dhe palës kundërshtare të incizimeve zanore dhe me video të intervistave me dëshmitarët dhe me mundësinë për t'u përfshirë në dokumentacion, nuk janë proporcionale me synimet për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ruajtjen e provave dhe se do të duhej të mendoheshin masa më pak kufizuese për zvogëlimin e rrezikut të deklaruar ("Pika e Katërt e Selimit").¹⁰

C. MBROJTJA E KRASNIQIT

8. Mbrojtja e Krasniqit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar lidhur me gjashtë pikat e mëposhtme:

- (1) Nëse në Vendimin e Kundërshtuar bëhet gabim juridik me zbatimin e Kornizës pa vendosur së pari se është e domosdoshme ("Pika e Parë e Krasniqit");
- (2) Nëse, për aq sa Vendimi i Kundërshtuar ka konstatuar se ishte e domosdoshme vendosja e një kornize në këtë fazë të procedurës, Vendimi i Kundërshtuar ka bërë gabim faktik ose juridik me konstatimin se ishte i domosdoshëm zbatimi i një kornize ("Pika e Dytë e Krasniqit");
- (3) Nëse Vendimi i Kundërshtuar ka bërë gabim juridik dhe faktik me zbatimin e një kornize e cila mbulon të gjithë dëshmitarët të cilët synon t'i thërrasë pala,

¹⁰ Kërkesa e Selimit, para. 1; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 13.

dhe jo vetëm ata dëshmitarë të cilët kanë nevojë për mbrojtje nga korniza (“Pika e Tretë e Krasniqit”);

- (4) Nëse në Vendimin e Kundërshtuar është gabim konstatimi se “duke pasur parasysh se të Akuzuarit i kërkojnë të drejtat e tyre për mbrojtje përmes mbrojtësve, Korniza e Propozuar duhet medoemos të sigurojë që mbrojtësit të veprojnë në përputhje me konstatimet e lartpërmendura lidhur me rreziqet me të cilat përballen individët e përmendur dhe me atmosferën e ndërhyrjes” (“Pika e Katërt e Krasniqit”);
- (5) Nëse në Vendimin e Kundërshtuar është gabuar me konstatimin se zbatimi i Kornizës ishte i përligjur për të mbrojtur privatësinë e dëshmitarëve ose për të ruajtur provat ose kryerjen e shpejtë të procesit (“Pika e Pestë e Krasniqit”); dhe
- (6) Nëse në Vendimin e Kundërshtuar është bërë gabim juridik me konstatimin se [...] Korniza nuk shkel të drejtat e të Akuzuarve, konkretisht të drejtën mosinkriminimin e vetës e dhe të drejtën për barazi të palëve (“Pika e Gjashtë e Krasniqit”).¹¹

D. MBROJTJA E VESELIT

9. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar lidhur me tri pikat e mëposhtme:

- (1) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar me vlerësimin e bazës ligjore për miratimin e Kornizës së Propozuar të ZPS-së (“Pika e Parë e Veselit”);
- (2) Nëse Korniza shkel të drejtat e të Akuzuarve për gjykim të drejtë (“Pika e Dytë e Veselit”); dhe
- (3) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka diskriminuar z. Veseli dhe të akuzuarit e tjerë të çështjes KSC-BC-2020-06 në raport me të akuzuar të tjerë

¹¹ Kërkesa e Krasniqit, para. 2; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 10.

në situata të ngjashme para [Dhomave të Specializuara] ("Pika e Tretë e Veselit").¹²

E. ZPS

10. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesat e Mbrojtjes duhet të hidhen poshtë sepse: (i) pikat e ngritura nuk përmbushin kriteret e lejes për apel sipas nenit 45 të Ligjit dhe rregullës 77 të Rregullores; dhe/ose (ii) Mbrojta nuk përmbush detyrimet lidhur me disa ose të gjitha kriteret.¹³ Sa i takon Kërkesës së Thaçit dhe Kërkesës së Krasniqit, ZPS-ja parashtroi në veçanti se nuk përcaktojnë mjaftueshëm gabimet e pretenduara.¹⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Sipas nenit 45 të Ligjit, Paneli i Gjykatës së Apelit shqyrton apele të ndërmjetme të paraqitura nga të akuzuarit ose nga ZPS-ja në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren. Për apelet e ndërmjetme, përveç atyre që janë automatikisht të lejueshme, duhet të miratohet leje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose trupi gjykues, mbi bazën se kanë të bëjnë me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit dhe për të cilën, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose të trupit gjykues, një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuonte thelbësisht në ecurinë e procesit.

12. Rregulla 77(2) e Rregullores përcakton gjithashtu se paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e

¹² Kërkesa e Veselit, para. 2.

¹³ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 1-2, 26; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 1, 16; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 1, 19; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 1, 14.

¹⁴ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 2; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 1.

përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën një vendim i menjëhershëm nga ana e Panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në ecurinë e procesit.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI LIGJOR

13. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se e drejta për apel lind vetëm nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është përmbushur standardi ligjor për miratimin e lejes për apel, i përcaktuar në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores.¹⁵ Interpretimi i këtyre dispozitave është përcaktuar me hollësi më parë.¹⁶

14. Duke pasur parasysh llojin kufizues të këtij mjeti juridik, zbatohen kriteret në vijim:

- (1) Nëse pika e ngritur përbën “pika të apelueshme”;
- (2) Nëse pika në fjalë do të ndikonte ndjeshëm në:
 - i. kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose
 - ii. rezultatin e gjykimit; dhe
- (3) Nëse, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në ecurinë e procesit.¹⁷

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel* (“Vendimi mbi Lejen për Apel”), 11 janar 2021, publik, para. 9.

¹⁶ Vendimi mbi Lejen për Apel, para. 10-17.

¹⁷ Vendimi mbi Lejen për Apel, para. 10.

B. PIKAT PËR TË CILAT MIRATOHET LEJA PËR APEL**1. Pika e Dytë e Thaçit, Pika e Pestë e Krasniqit dhe Pika e Parë e Veselit**

15. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, Pika e Dytë e Thaçit ka të bëjë me interpretimin e nenit 39(11) të Ligjit sepse kundërshton se dispozita në fjalë (dhe në veçanti fraza “kur është e nevojshme”) i jep kompetencë Gjykatësit të Procedurës Paraprake të miratojë Kornizën dhe masat që përmban ajo.¹⁸ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit argumenton se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse ka të bëjë: (i) në veçanti, me të drejtën e z. Thaçi për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm; dhe (ii) me problemin qendror të arritjes së një drejtpeshimi, siç e kërkon neni 39(11) i Ligjit, midis të drejtave të z. Thaçi, nga njëra anë, dhe mbrojtjes dhe privatësisë së dëshmitarëve, nga ana tjetër.¹⁹ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtrohet se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë fazë është e nevojshme për të parandaluar cenim të pariparueshëm të shkaktuar nga Korniza ndaj hetimeve të tanishme të Mbrojtjes dhe ndaj të drejtave të z. Thaçi.²⁰

16. Në mënyrë të ngjashme, Mbrojtja e Krasniqit argumenton në Pikën e Pestë të Krasniqit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka gabuar me konstatimin se miratimi i Kornizës ishte i domosdoshëm për të mbrojtur privatësinë e dëshmitarëve dhe për të siguruar ruajtjen e provave ose kryerjen e shpejtë të procesit.²¹ Mbrojtja e Krasniqit argumenton gjithashtu se kjo pikë ka pasoja të konsiderueshme për kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, në veçanti sepse zbatimi i hapave shtesë që duhen kryer nga Mbrojtja bën që Mbrojtjes t’i duhet kohë shtesë, çka nga ana e vet prek kohëzgjatjen e procesit dhe të drejtën e z.

¹⁸ Kërkesa e Thaçit, para. 4, 6 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 120), 8.

¹⁹ Kërkesa e Thaçit, para. 12-13.

²⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

²¹ Kërkesa e Krasniqit, para. 2, 26 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 121, 123-125).

Krasniqi për gjykim të shpejtë.²² Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se një zgjidhje e menjëhershme e kësaj pike nga Paneli i Gjykatës së Apelit do të kontribuojë thelbësisht në ecurinë e procesit duke penguar devijimin e tyre në rrugë të gabuar dhe duke zvogëluar kohën për debate gjyqësore.²³

17. Në thelb, Mbrojtja e Veselit argumenton në Pikën e Parë të Veselit se Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) nuk ka vërtetuar se neni 39(11) i Ligjit parasheh një bazë ligjore të pavarur për Kornizën; (ii) nuk përcakton se si duhet të shqyrtohet domosdoshmëria e ndërhyrjes gjyqësore në pajtim me nenin 39(11) të Ligjit; dhe (iii) me miratimin e Kornizës ka shpërdoruar diskrecionin e tij dhe ka tejkaluar kompetencat që ia jep korniza ligjore e DHS-së.²⁴ Mbrojtja e Veselit argumenton gjithashtu se kjo pikë prek drejtpërdrejt rezultatit e procesit, duke shkelur potencialisht të drejtën e z. Veseli për gjykim të drejtë, e drejtë kjo që mbrohet nga Kushtetuta e Kosovës dhe nga instrumentet ndërkombëtare përkatëse për të drejtat e njeriut.²⁵ Së fundi, Mbrojtja e Veselit argumenton se përligjet një vendim nga Paneli i Gjykatës së Apelit në këtë fazë sepse do të shmangte rrezikun e cenimit ndaj z. Veseli dhe do të siguronte qartësi në lidhje me bazën ligjore të Kornizës.²⁶

18. ZPS-ja përgjigjet, lidhur me Pikën e Dytë të Thaçit, se duke prezumuar që Korniza duhej të përfshihej vetëm brenda nenit 39(11) të Ligjit, Mbrojtja e Thaçit e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar, që thotë se Korniza bazohet edhe në nenet 35(2)(f) dhe 39(1) të Ligjit. Sipas ZPS-së, interpretimi i nenit 39(11) të Ligjit përbën, rrjedhimisht, një çështje teorike e cila nuk e përmbush standardin e lejes për apel.²⁷ ZPS-ja parashton gjithashtu se Mbrojtja e Thaçit nuk vërteton se kjo pikë do të

²² Kërkesa e Krasniqit, para. 27 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 164).

²³ Kërkesa e Krasniqit, para. 28.

²⁴ Kërkesa e Veselit, para. 2, 5-8 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 115-136, në veçanti para. 117, 135-136).

²⁵ Kërkesa e Veselit, para. 12.

²⁶ Kërkesa e Veselit, para. 13.

²⁷ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 7 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 115).

ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe rezultatin e gjykimit.²⁸ Lidhur me Pikën e Pestë të Krasniqit dhe Pikën e Parë të Veselit, ZPS-ja në thelb përgjigjet se nuk përbëjnë pika të apelueshme sepse nuk janë në mënyrë të mjaftueshme konkrete apo të veçanta dhe përbëjnë thjesht mospajtim me konstatimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake.²⁹ Krahas kësaj, ZPS-ja argumenton lidhur me Pikën e Parë të Veselit se: (i) shtrembërn Vendimin e Kundërshtuar; dhe (ii) Mbrojtja e Veselit nuk përmbush standardin në lidhje me nëse kjo pikë do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit dhe nëse një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në ecurinë e procesit.³⁰

19. *Pika e apelueshme.* Duke vënë re se një “pikë” është “temë ose lëndë e identifikueshme, zgjidhja e së cilës është kyçe për përcaktimin e problemeve që dalin në çështjen gjyqësore që shqyrtohet, dhe jo thjesht një aspekt për të cilën ka mospajtime ose mendime të kundërta”,³¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se të tria pikat kanë të bëjnë vetëm me temën e përputhshmërisë së Kornizës me nenin 39(11) të Ligjit, në veçanti nëse miratimi i Kornizës ishte i domosdoshëm për mbrojtjen dhe privatësinë e dëshmitarëve, ruajtjen e provave dhe kryerjen e shpejtë të procesit.³² Të tria pikat rrjedhin nga paragrafët 115-136 të Vendimit të Kundërshtuar, ku diskutohej baza ligjore e Kornizës. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se të tria pikat janë pika të apelueshme.

²⁸ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 8-10.

²⁹ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 3, 5-6; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 2-5.

³⁰ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 5, 12-13.

³¹ Vendimi mbi Lejen për Apel, para. 11.

³² *Shih, në veçanti*, Kërkesën e Thaçit, para. 6, 8; Kërkesën e Krasniqit, para. 2, 26; Kërkesën e Veselit, para. 7-8. Mirëpo, sa i takon Pikës së Parë të Veselit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake sqaron se, për dallim nga ajo që duket se sugjeron Mbrojtja e Veselit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e miratoi pa ndryshime Kornizën e Propozuar të ZPS-së.

20. *Drejtësia dhe shpejtësia.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se të tria pikat do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë të procesit, sepse kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e nenit 39(11) të Ligjit dhe, kështu, me pika themelore të bazës ligjore të Kornizës dhe përputhshmërisë me kornizën ligjore të DHS-së, si edhe me kompetencat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për ta miratuar Kornizën. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu është bindur se të tria pikat do të preknin ndjeshëm kryerjen e shpejtë të procesit, sepse një zgjidhje e hershme e këtyre pikave do të thjeshtonte edhe procesin dhe do të ndihmonte, në veçanti, të drejtën e të Akuzuarve për kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes (neni 21(4)(c) i Ligjit) dhe për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm (neni 21(4)(d) i Ligjit).

21. *Të avancohet thelbësisht procesi.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se një zgjidhje e menjëhershme e këtyre pikave nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit sepse kjo: (i) do të siguronte qartësim të mëtejshëm për hetimet e Mbrojtjes; dhe (ii) do të minimizonte vonesat dhe shmangien e burimeve në faza të mëpasshme të procesit drejt trajtimit të pretendimeve të ngritura në këtë aspekt.

22. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton lejen për të apeluar Pikën e Dytë të Thaçit, Pikën e Pestë të Krasniqit dhe Pikën e Parë të Veselit.

2. Pika e Gjashtë e Krasniqit

23. Mbrojtja e Krasniqit parashtroi se kjo pikë kundërshton përfundimin qendror të Vendimit të Kundërshtuar se Korniza nuk shkel të drejtën për të mos inkriminuar veten ose të drejtën e palëve për mundësi të barabarta në paraqitjen

e provave të veta.³³ Mbrojtja e Krasniqit parashtrohet gjithashtu se kjo pikë në vetvete ka të bëjë me kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse lidhet drejtpërdrejt me të drejtat e lartpërmendura për gjykim të drejtë.³⁴ Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit parashtrohet se, duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtave për gjykim të drejtë, nevojitet një sqarim i mëtijshëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit për të siguruar që procesi të ndjekë rrugën e duhur.³⁵

24. ZPS-ja përgjigjet se kjo nuk është pikë e apelueshme sepse Mbrojtja e Krasniqit nuk identifikon asnjë gabim konkret, por vetëm shpreh mospajtim me konstatimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake.³⁶ Krahas kësaj, ZPS-ja parashtrohet se Mbrojtja e Krasniqit nuk jep asnjë bazë ligjore për pretendimin se të drejtat për gjykim të drejtë do të ndikoheshin nga Korniza, duke mos treguar se kjo pikë do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatin e gjykimit.³⁷

25. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo pikë ka të bëjë me paragrafët 137-163 të Vendimit të Kundërshtuar që kanë të bëjnë me aspektin e përputhshmërisë së Kornizës me të drejtën për të mos inkriminuar veten (neni 21(4)(h) i Ligjit) dhe parimin e barazisë mes palëve (neni 6(1) i Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ["KEDNJ"]). Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo përbën pikë të apelueshme.

26. *Drejtësia dhe shpejtësia.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se kjo pikë do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit. Kjo pikë ka të bëjë me të drejtën e të Akuzuarve për të mos e inkriminuar veten, siç mishërohet

³³ Kërkesa e Krasniqit, para. 29 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 138-163, në veçanti para. 140-145, 150-154, 159-163).

³⁴ Kërkesa e Krasniqit, para. 30 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 138-145, 150).

³⁵ Kërkesa e Krasniqit, para. 31.

³⁶ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 18.

³⁷ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 17.

në nenin 21(4)(h) të Ligjit, dhe parimin e barazisë mes palëve, që ndikojnë të dyja në drejtësinë e procesit. Krahas kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se është e rëndësishme zgjidhja që në fillim e kësaj pike, për të thjeshtuar procesin dhe për të ndihmuar, në veçanti, të drejtën e të Akuzuarve për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes (neni 21(4)(c) i Ligjit) dhe për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm (neni 21(4)(d) i Ligjit).

27. *Të avancohet thelbësisht procesi.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, për arsyet e paraqitura në paragrafin 21 më lart, një zgjidhje e menjëhershme e kësaj pike nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit.

28. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton lejen për të apeluar Pikën e Gjashtë të Krasniqit.

3. Pika e Katërt e Thaçit, Pika e Tretë e Krasniqit dhe Pika e Parë e Selimit

29. Mbrojtja e Thaçit parashtroi se Pika e Katërt e Thaçit, që kundërshton zbatimin e Kornizës për dëshmitarët e ZPS-së pavarësisht “kategorisë” së tyre, ngre një problem të qartë dhe të veçantë lidhur me fushëveprimin dhe kushtet e nenit 39(11) të Ligjit dhe zbatimin e tij, dhe rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar.³⁸ Argumentet e Mbrojtjes së Thaçit se kjo pikë do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit paraqiten në paragrafin 15 më lart.³⁹ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtroi se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit është e përligjur në këtë fazë, sepse në qoftë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka vendosur gabimisht që Korniza të zbatohet për të gjithë dëshmitarët

³⁸ Kërkesa e Thaçit, para. 6, 7, 8; Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 4.

³⁹ Kërkesa e Thaçit, para. 12-13.

e ZPS-së, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të tanishme Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.⁴⁰

30. Mbrojtja e Krasniqit parashtron se Pika e Tretë e Krasniqit rrjedh drejtpërdrejt nga Vendimi i Kundërshtuar, për të kundërshtuar zbatueshmërinë e Kornizës për të gjithë dëshmitarët e përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarët e tjerë të njoftuar, pa bërë dallimin nëse kanë nevojë për mbrojtje.⁴¹ Mbrojtja e Krasniqit parashtron gjithashtu se kjo pikë prek ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse: (i) Korniza në përgjithësi vendos kufizime mbi mundësinë e Mbrojtjes për të kontaktuar dëshmitarë dhe kërkon nga ekipet e Mbrojtjes të marrin hapa shtesë; dhe (ii) nëse Korniza do të zbatohet për një numër më të vogël dëshmitarësh, atëherë do të ishte më e vogël barra administrative që vendos ajo.⁴² Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit parashtron se një zgjidhje e menjëhershme e kësaj pike nga Paneli i Gjykatës së Apelit do të kontribuonte thelbësisht në avancimin e procesit, sepse drejtësia e procesit do të njollosej nëse Korniza do të zbatohet gabimisht (dhe kështu do të kufizoheshin gabimisht hetimet e ardhshme të Mbrojtjes).⁴³

31. Mbrojtja e Selimit parashtron se Pika e Parë e Selimit rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar.⁴⁴ Mbrojtja nuk vë në dyshim nëse Korniza duhet, teorikisht, të jetë e zbatueshme për të gjithë dëshmitarët. Në vend të kësaj, ajo vë në dyshim nëse, duke mbajtur parasysh frazën “kur është e nevojshme” që përmban neni 39(11) i Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të duhej, për dëshmitarët ndërkombëtarë dhe personat jo në rrezik, të paktën të kishte vendosur një lidhje midis rrezikut dhe rrethanave individuale të dëshmitarit në fjalë.⁴⁵ Mbrojtja e

⁴⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

⁴¹ Kërkesa e Krasniqit, para. 2, 21 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 120, 135).

⁴² Kërkesa e Krasniqit, para. 17, 22.

⁴³ Kërkesa e Krasniqit, para. 18, 22.

⁴⁴ Kërkesa e Selimit, para. 9.

⁴⁵ Kërkesa e Selimit, para. 1, 10, 15-16 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 115-118, 120, 135, 169, 173, 198); *shih edhe* Kundërpërgjigja e Selimit, para. 2.

Selimit parashtroi gjithashtu se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë të procesit sepse Vendimi i Kundërshtuar mbështetet në shpërdorimin e diskrecionit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që ndikon në sjelljen e Mbrojtjes gjatë gjykimit. Sa i takon shpejtësisë, Mbrojtja e Selimit pretendon se Korniza haptazi e gjerë ndikon në sjelljen e Mbrojtjes lidhur me hetimet dhe intervistat deri edhe pasi të ketë filluar faza e gjykimit, duke shkaktuar vonesa të panevojshme të hetimit (po të mbahet parasysh se hetimet e Mbrojtjes do të vijojnë edhe gjatë fazës së gjykimit).⁴⁶ Së fundi, Mbrojtja e Selimit parashtroi se një ndërhyrje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të eliminonte nga procesi gabimet e mundshme dhe t'u jepte atyre kursin e duhur.⁴⁷

32. ZPS-ja përgjigjet, lidhur me Pikën e Katërt të Thaçit, se Mbrojtja e Thaçit e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar duke mos marrë parasysh se: (i) Korniza nuk mbështetet vetëm në nenin 39(11) të Ligjit, por edhe në nenet 35(2)(f) dhe 39(1) të Ligjit; dhe (ii) garancitë kompensuese të Kornizës e përshtatin zbatimin e saj sipas rrethanave të dëshmitarëve.⁴⁸ Sa i takon Pikës së Tretë të Krasniqit dhe Pikës së Parë të Selimit, ZPS-ja përgjigjet, në veçanti, se nuk marrin parasysh se: (i) Gjykatësi i Procedurës Paraprake doli në konstatim të domosdoshmërisë i cili ndër të tjera merrte parasysh rrethanat e dëshmitarëve përkatës; dhe (ii) garancitë kompensuese të Kornizës e përshtatin zbatimin e saj sipas rrethanave specifike të dëshmitarëve.⁴⁹ Krahës kësaj, ZPS-ja parashtroi se Pika e Tretë e Krasniqit nuk është në mënyrë të mjaftueshme e ndarë dhe nuk identifikon një gabim të dallueshëm në mënyrë të mjaftueshme,⁵⁰ ndërsa zgjidhja e Pikës së Parë të Selimit

⁴⁶ Kërkesa e Selimit, para. 17, 25-28; *shih edhe* Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 4.

⁴⁷ Kërkesa e Selimit, para. 25-28.

⁴⁸ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 7-8 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 115, 119).

⁴⁹ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 8 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 119-120); Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 3 (*ku i referohet, në veçanti, Vendimit të Kundërshtuar, para. 119-120*).

⁵⁰ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 7.

nuk do të ishte thelbësore, siç e kërkon standardi i lejes për apel.⁵¹ Së fundi, lidhur me të tria pikat, ZPS-ja parashton se ekipi përkatës i Mbrojtjes nuk vërteton se pika do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatin e gjykimit.⁵²

33. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se të tria pikat rrjedhin, në veçanti, nga paragrafi 120 i Vendimit të Kundërshtuar, ku diskutohet nëse “kategori” të caktuara të dëshmitarëve duhen përjashtuar nga Korniza. Pavarësisht nga disa dallime të caktuara midis Pikës së Katërt të Thaçit dhe Pikës së Tretë të Krasniqit, nga njëra anë,⁵³ dhe Pikës së Parë të Selimit, nga ana tjetër,⁵⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se ato ngrenë në thelb dyshimin nëse Korniza duhet të zbatohet për të gjithë dëshmitarët, pa bërë dallimin nëse kanë nevojë për mbrojtje. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këto pika përbëjnë pika të apelueshme.

34. *Drejtësia dhe shpejtësia.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, për arsyet e paraqitura në paragrafin 20 më lart, të tria pikat do të ndikonin në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

35. *Të avancohet thelbësisht procesi.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, për arsyet e paraqitura në paragrafin 21 më lart, një zgjidhje e menjëhershme e këtyre pikave nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit.

⁵¹ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 3 (ku i referohet, ndër të tjera, Vendimit të Kundërshtuar, para. 114-125).

⁵² Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 8-10; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 9-11; Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 4-6.

⁵³ Ku pretendohet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të kishte bërë dallimin midis “kategorive” të ndryshme të dëshmitarëve.

⁵⁴ Ku pretendohet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të paktën të kishte vërtetuar lidhjen midis rrezikut dhe rrethanave individuale të dëshmitarit në fjalë.

36. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton lejen për apelim të Pikës së Katërt të Thaçit, Pikës së Tretë të Krasniqit dhe Pikës së Parë të Selimit.

4. Pika e Parë e Thaçit

37. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, në këtë pikë kërkohet vendim nga apeli nëse masat e incizimit me video dhe nxjerrjes së intervistave me dëshmitarët ("incizimi dhe nxjerrja") shkelin konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient dhe të drejtën e të akuzuarit për të hetuar provat kundër tij (që rrjedh nga e drejta për t'u përfaqësuar nga mbrojtësit dhe për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes).⁵⁵ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit në thelb argumenton se, për shkak të kësaj dhe ngaqë incizimi dhe nxjerrja i zgjatë më shumë në kohë hetimet e Mbrojtjes, kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.⁵⁶ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit argumenton se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit është e përligjur në këtë fazë, sepse nëse zbatimi i incizimit dhe nxjerrjes shkel konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient dhe të drejtën e z. Thaçi për të hetuar provat kundër tij, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të tanishme të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.⁵⁷

38. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Thaçit, përveç që nuk i referohet Vendimit të Kundërshtuar, nuk artikulon qartë një gabim konkret, duke shprehur kështu thjesht mospajtim me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. ZPS-ja parashtrohet gjithashtu se Mbrojtja e Thaçit nuk paraqet prova për ndonjë ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatin e gjykimit.⁵⁸

⁵⁵ Kërkesa e Thaçit, para. 6, 8; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 3.

⁵⁶ Kërkesa e Thaçit, para. 12-13.

⁵⁷ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

⁵⁸ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 4-6.

39. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake, duke vënë në dukje se Mbrojtja e Thaçit nuk identifikon pjesë konkrete të Vendimit të Kundërshtuar, gjykon se kjo pikë rrjedh në veçanti nga paragrafi 212.II.j.iv. dhe n.ii. i Vendimit të Kundërshtuar. Më përgjithësisht, gjithashtu rrjedh nga paragrafët 147-177 të Vendimit të Kundërshtuar (“balancimi i të drejtave për gjykim të drejtë”), në veçanti paragrafët 155-160 (“nxjerrja”) dhe 171-176 (“koha dhe mjetet e mjaftueshme”), për aq sa kanë të bëjnë me incizimin dhe nxjerrjen. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo përbën pikë të apelueshme.

40. *Drejtësia dhe shpejtësia.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se kjo pikë ka të bëjë në veçanti me të drejtën e z. Thaçi për të komunikuar privatisht me mbrojtësin e tij dhe për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes (neni 6(3)(b) dhe (c) i KEDNJ-së dhe neni 21(4)(c) dhe (e) i Ligjit). Nëse masat e incizimit dhe nxjerrjes i shkelin këto të drejta, kryerja e drejtë e procesit do të cenohej ndjeshëm. Krahës kësaj, një zgjidhje e hershme e kësaj pike do t'i thjeshtonte procesin dhe do të ndihmonte të drejtën e Akuzuarve për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm (neni 21(4)(d) i Ligjit). Prandaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se kjo pikë do të prekte ndjeshëm kryerjen e shpejtë të procesit.

41. *Të avancohet thelbësisht procesi.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, për arsyet e paraqitura në pikën 21 më lart, një zgjidhje e menjëhershme e kësaj pike nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit.

42. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton lejen për apelimin e Pikës së Parë të Thaçit.

5. Pika e Katërt e Selimit dhe Pika e Tetë e Thaçit

43. Mbrojtja e Selimit parashtron se kjo pikë vë në dyshim nëse zbatimi i incizimit dhe nxjerrjes (përkatësisht dorëzimi i një kopjeje Panelit) ishte e domosdoshëm dhe proporcional për sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe ruajtjes së provave.⁵⁹ Mbrojtja e Selimit parashtron gjithashtu se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse incizimi dhe nxjerrja (përkatësisht dorëzimi i një kopjeje Panelit), siç është formuluar aktualisht në Kornizë: (i) do të ishte një monitorim i panevojshëm dhe i vazhdueshëm i hetimeve të Mbrojtjes nga ana e ZPS-së dhe Panelit; dhe (ii) do të binte kështu ndesh me qëllimin e garancive gjyqësore lidhur me praninë e palës kundërshtare gjatë intervistave, në kundërshtim me preferencën e shprehur të atij dëshmitari.⁶⁰ Argumentet e Mbrojtjes së Selimit se një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuonte thelbësisht në avancimin e procesit paraqiten në paragrafin 31 më lart.

44. Mbrojtja e Thaçit argumenton se në këtë pikë kërkohet vendim në apel nëse zbatimi i incizimit dhe nxjerrjes është në përputhje me rregullat 104-111 të Rregullores.⁶¹ Mbrojtja e Thaçit argumenton gjithashtu se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit sepse ka të bëjë me: (i) përputhshmërinë e masave me garancitë që i jep Mbrojtjes korniza ligjore e DHS-së; (ii) nxjerrjen e informacionit të privilegjuar ose produktit të punës, duke ndikuar kështu ndjeshëm në të drejtën e z. Thaçi për të pasur mbrojtës dhe kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes; dhe (iii) një gabim procedural i cili do t'i bëjë intervistat e Mbrojtjes më komplekse, më të vështira dhe që kërkojnë kohë.⁶² Së fundi, Mbrojtja e Thaçit argumenton se ndërhyrja nga

⁵⁹ Kërkesa e Selimit, para. 1, 12, 22-23 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 115, 124, 142-143, 151, 159, 170, 212.II.n.ii. dhe o.); *shih edhe* Kundërpërgjigja e Selimit, para. 12.

⁶⁰ Kërkesa e Selimit, para. 24.

⁶¹ Kërkesa e Thaçit, para. 6, 9; *shih edhe* Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 6.

⁶² Kërkesa e Thaçit, para. 12, 14.

Paneli i Gjykatës së Apelit në këtë fazë është e përligjur, sepse, në qoftë se zbatimi i incizimit dhe nxjerrjes shkel rregullat 104-111 të Rregullores, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të tanishme të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.⁶³

45. Sa i takon Pikës së Katërt të Selimit, ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Selimit nuk tregon ndonjë gabim të veçantë, por thjesht kundërshton ushtrimin e diskrecionit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe vetëm shpreh kështu mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar.⁶⁴ Sa i takon Pikës së Tetë të Thaçit, ZPS-ja përgjigjet ndër të tjera se, përmes ngritjes së këtij dyshimi kaq të përgjithshëm mbi përputhshmërinë e Kornizës me rregullat 104-111 të Rregullores (që mbulojnë një gamë të tjerë dispozitash, përfshirë shumë rregulla që kanë të bëjnë vetëm me detyrimet e ZPS-së), Mbrojtja e Thaçit nuk identifikon një pikë/gabim mjaftueshëm të veçantë.⁶⁵

46. *Pika e apelueshme.* Sa i takon Pikës së Katërt të Selimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se kjo pikë rrjedh nga paragrafi 212.II.j.iv. dhe n.ii. i Vendimit të Kundërshtuar, dhe përgjithësisht nga konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në paragrafët 114-136 (mbi bazën ligjore dhe fushëveprimin e Kornizës) dhe 147-160 (për balancimin e të drejtave për gjykim të drejtë dhe për nxjerrjen), për aq sa kanë të bëjnë me incizimin dhe nxjerrjen (përkatësisht dorëzimin e një kopjeje Panelit). Sa i takon Pikës së Tetë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, duke vënë në dukje formulimin shumë të gjerë të kësaj pike, kupton se Mbrojtja e Thaçit u referohet konstatimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në paragrafët 155-157 të Vendimit të Kundërshtuar, lidhur me shqetësimin e Mbrojtjes për nxjerrjen e materialeve të cilat përndryshe nuk do ishte e nevojshme të nxirreshin.⁶⁶ Në këtë mënyrë, kjo pikë ka të bëjë në veçanti

⁶³ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

⁶⁴ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 15.

⁶⁵ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 16.

⁶⁶ *Shih* Kërkesën e Thaçit, para. 14 (“informacioni i privilegjuar ose produkti i punës”).

me pyetjen nëse masat e incizimit dhe nxjerrjes janë në përputhje me rregullat 106 dhe/ose 111(1) të Rregullores. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se të dyja pikat rrjedhin nga Vendimi i Kundërshtuar dhe përbëjnë pika të apelueshme.

47. *Drejtësia dhe shpejtësia.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se të dyja pikat do të preknin ndjeshëm kryerjen e drejtë të procesit, sepse kanë të bëjnë me pyetjen qendrore të përputhshmërisë së paragrafit 212.II.j.iv. dhe n.ii. të Vendimit të Kundërshtuar me kornizën ligjore të DHS-së. Krahas kësaj, një zgjidhje e hershme e këtyre pikave do ta thjeshtonte procesin dhe do të ndihmonte në veçanti të drejtën e të Akuzuarve për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes (neni 21(4)(c) i Ligjit) dhe për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm (neni 21(4)(d) i Ligjit). Pra, të dyja pikat do të ndikonin ndjeshëm edhe në kryerjen e shpejtë të procesit.

48. *Të avancohet thelbësisht procesi.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, për arsyet e paraqitura në paragrafin 21 më lart, një zgjidhje e menjëhershme të dyja pikave nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit.

49. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton lejen për të apeluar Pikën e Katërt të Selimit dhe Pikën e Tetë të Thaçit.

C. PIKAT PËR TË CILAT REFUZOHE LEJA PËR APEL

1. Pika e Tretë e Thaçit

50. Mbrojtja e Thaçit parashtron se kjo pikë kërkon zgjidhje për aspektin nëse, në bazë të lidhjes me pikën nën shqyrtim, Gjykatësit të Procedurës Paraprake i lejohej ligjërisht të mos merrte në konsideratë Parashtrimet Shtesë të Thaçit⁶⁷ (të cilat

⁶⁷ KSC-BC-2020-06, F00741, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime Shtesë të Mbrojtjes së Thaçit mbi Kornizën e Propozuar të ZPS-së për Kontaktet me Dëshmitarët*, 21 mars 2022, publik.

pretendohet se kërkonin të tregonin se lista e dëshmitarëve të ZPS-së sipas rregullës 95(4)(b) të Rregullores ("Lista e Dëshmitarëve e ZPS-së") përfshin persona të cilët as nuk kanë dijeni se janë në listë dhe as nuk kanë dhënë pëlqim të jenë në listë).⁶⁸ Mbrojtja e Thaçit parashtron gjithashtu se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse: (i) ka të bëjë me të drejtën e z. Thaçi për të hetuar provat kundër tij (çka rrjedh nga e drejta e tij për të pasur mbrojtës dhe për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij); dhe (ii) gjatësia e Listës së Dëshmitarëve të ZPS-së (çka ka pasoja për zbatimin e Kornizës) ndikon ndjeshëm në shpejtësinë e procesit.⁶⁹ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit argumenton se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë fazë është e përligjur sepse në qoftë se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gabimisht i ka shpërfillur Parashtrimet Shtesë të Thaçit, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të tanishme të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.⁷⁰

51. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Thaçit nuk ngre ndonjë problem ligjor që vjen nga refuzimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të marrë në konsideratë Parashtrimet Shtesë të Thaçit, të cilat, sipas mendimit të ZPS-së, u dorëzuan në shpërfillje të Rregullores dhe të afateve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për parashtrimet. ZPS-ja parashtron gjithashtu se kjo pikë nuk do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo në rezultatin e gjykimit.⁷¹

52. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafët 109-110 të Vendimit të Kundërshtuar thonë shprehimisht se Parashtrimet Shtesë të Thaçit nuk u morën më tej në shqyrtim sepse Mbrojtja e Thaçit nuk ishte përpjekur të tregonte një bazë ligjore për bërjen e parashtrimeve shtesë dhe as nuk kishte

⁶⁸ Kërkesa e Thaçit, para. 6 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 109-110), 8, 13 (ku u referohet Parashtrimeve Shtesë të Thaçit, para. 10-12); shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 4.

⁶⁹ Kërkesa e Thaçit, para. 12-13.

⁷⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

⁷¹ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 11.

kërkuar lejen e domosdoshme për bërjen e tyre. Kërkesa e Thaçit nuk paraqet asnjë argument juridik lidhur me pranueshmërinë e parashtrimeve shtesë por vetëm sa flet për kontekstin e këtyre parashtrimeve. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja e Thaçit nuk tregon një gabim dhe nuk paraqet kështu një pikë të apeluarshme. Rrjedhimisht, refuzohet leja për të apeluar Pikën e Tretë të Thaçit.

2. Pika e Pestë dhe Pika e Gjashtë e Thaçit

53. Mbrojtja e Thaçit parashtron se, sa i takon Pikës së Pestë të Thaçit, me zbatimin e incizimit dhe nxjerrjes mbështetur në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në ta dhe ndikimit të vijuar të konsiderueshëm të të Akuzuarve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) ka shkelur prezumimin se Mbrojtja vepron në mirëbesim; dhe (ii) ka vendosur standard të dyfishtë për Mbrojtjen (në raport me ZPS-në).⁷² Sa i takon Pikës së Gjashtë të Thaçit, Mbrojtja e Thaçit parashtron gjithashtu se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka zbatuar një standard të dyfishtë të palejueshëm duke u mbështetur në “rreziqet e konstatuara të nxjerrjes së informacionit për Mbrojtjen” për të përligjur zbatimin e incizimit dhe nxjerrjes.⁷³ Mbrojtja e Thaçit parashtron gjithashtu se këto dy pika ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse: (i) ndikojnë në të drejtën e z. Thaçi për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, sipas nenit 21(4)(c) të Ligjit, dhe të drejtën për ta pasur këtë garanci “me barazi të plotë”, sipas pjesës së përgjithshme të nenit 21(4) të Ligjit; dhe (ii) identifikojnë një gabim procedural i cili do t’i bëjë intervistat e Mbrojtjes më komplekse, më të vështira dhe që marrin më shumë kohë.⁷⁴ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtron se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë

⁷² Kërkesa e Thaçit, para. 6 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 118), 9.

⁷³ Kërkesa e Thaçit, para. 6 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 124, 142-143), 9; shih edhe Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 5.

⁷⁴ Kërkesa e Thaçit, para. 12, 14.

fazë është e përligjur, sepse nëse zbatimi i incizimit dhe nxjerrjes është një masë e njëanshme, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të tanishme të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.⁷⁵

54. ZPS-ja përgjigjet se këto dy pika duhen rrëzuar sepse e shtrembërojnë Vendimin e Kundërshtuar. Në veçanti, ZPS-ja parashtron se kërkesa ligjore për të vepruar në mirëbesim rrjedh nga Korniza dhe zbatohet për çdo palë thirrëse kur kërkon pëlqimin e dëshmitarëve për t'u intervistuar. Së fundi, ZPS-ja parashtron se Vendimi i Kundërshtuar i ka trajtuar tashmë parashtrimet lidhur me pretendimin për mungesë besimi kundrejt Mbrojtjes dhe është shprehur se nuk nënkuptohet apo nuk prezumohet se avokati i mbrojtjes do të bëjë shkelje.⁷⁶

55. *Pika e apelueshme.* Sa i takon Pikës së Pestë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se atmosfera e konstatuar në mënyrë të përsëritur e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në ta dhe ndikimi në vijimësi i konsiderueshëm i ushtruar nga të Akuzuarit në këtë çështje gjyqësore janë përmendur në paragrafin 118 të Vendimit të Kundërshtuar për të shpjeguar funksionin mbrojtës të Kornizës.⁷⁷ Del qartë nga paragrafët 114-136 të Vendimit të Kundërshtuar se masat e incizimit dhe nxjerrjes nuk mbështeten (vetëm) në këto aspekte. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se: (i) garancitë e Kornizës zbatohen vetëm me kërkesë të dëshmitarit;⁷⁸ (ii) Korniza zbatohet jo vetëm për dëshmitarët e ZPS-së, por për të gjithë dëshmitarët e kësaj çështjeje gjyqësore;⁷⁹ dhe (iii) paragrafi 170 i Vendimit të Kundërshtuar e trajton tashmë shqetësimin e Mbrojtjes. Sa i takon Pikës së Gjashtë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se fraza për “rreziqet e konstatuara të nxjerrjes së informacionit për

⁷⁵ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

⁷⁶ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 14 (*ku i referohet në veçanti* Vendimit të Kundërshtuar, para. 170).

⁷⁷ Në veçanti për dëshmitarët për të cilët janë urdhëruar masa mbrojtëse në këto procedura, pas ose në momentin e përfundimit të afatit të këtyre masave (*shih* Vendimi i Kundërshtuar, para. 118 *in fine*).

⁷⁸ Vendimi i Kundërshtuar, para. 119.

⁷⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 116.

Mbrojtjen”: (i) lidhej qartë me “dëshmitarët që përfitojnë nga masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores”; dhe (ii) përdorej qartë për të treguar funksionin shtesë të Kornizës për të siguruar ruajtjen e provave, por jo për të përligjur në vetvete masat e incizimit dhe nxjerrjes.⁸⁰

56. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se këto dy pika nuk përbëjnë pika të apelueshme sepse e shtrembërojnë Vendimin e Kundërshtuar dhe nuk rrjedhin kështu prej tij. Rrjedhimisht, refuzohet leja për të apeluar Pikën e Pestë dhe Pikën e Gjashtë të Thaçit.

3. Pika e Shtatë, e Nëntë dhe e Njëmbëdhjetë e Thaçit dhe Pika e Tretë e Selimit

57. Me Pikën e Shtatë të Thaçit (lidhur me masat e incizimit dhe nxjerrjes), Mbrojtja e Thaçit pretendon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndoqi një përkufizim gabimisht të ngushtë të detyrimit në paragrafin 150 të Vendimit të Kundërshtuar.⁸¹ Me Pikën e Nëntë të Thaçit, Mbrojtja e Thaçit pyet nëse “konstatimi i bërë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake”⁸² duhet të shfuqizohet për shkak se Gjykatësi i Procedurës Paraprake u mbështet në faktin se incizimet e intervistave nuk bëjnë pjesë automatikisht në dokumentacion, pa marrë në konsideratë rreziqe të tjera praktike të shprehura nga Mbrojtja lidhur me incizimin dhe nxjerrjen.⁸³ Mbrojtja e Thaçit argumenton gjithashtu se Pika e Shtatë dhe Pika e Nëntë e Thaçit prekin në mënyrë të konsiderueshme kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit sepse (i) ndikojnë ndjeshëm në të drejtën për të mos fajësuar veten; dhe (ii) identifikojnë një gabim procedural i cili do t’i bëjë intervistat e mbrojtjes më komplekse, më të vështira dhe që marrin më shumë kohë.⁸⁴ Së fundi, siç e kupton Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja e Thaçit argumenton për

⁸⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 124.

⁸¹ Kërkesa e Thaçit, para. 6, 9.

⁸² Kërkesa e Thaçit, para. 9 (që nuk përcakton më tej se cilit konstatim i referohet Mbrojtja e Thaçit).

⁸³ Kërkesa e Thaçit, para. 6, 9; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 7.

⁸⁴ Kërkesa e Thaçit, para. 12, 14; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 6.

të dyja pikat që ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë fazë është e përligjur sepse, në qoftë se masat e incizimit dhe nxjerrjes shkelin të drejtën për të mos fajësuar veten, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.⁸⁵

58. Sa i takon Pikës së Njëmbëdhjetë të Thaçit, Mbrojtja e Thaçit parashtrohet se ka të bëjë me ndikimin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake (pretendohet se) nuk ka balancuar, kur ka zbatuar incizimin dhe nxjerrjen, pritjet e dëshmitarëve për privatësi me të drejtat e z. Thaçi për gjykim të drejtë.⁸⁶ Mbrojtja e Thaçit parashtrohet gjithashtu se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, në veçanti sepse ka pasoja të ndjeshme në të drejtën e z. Thaçi për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.⁸⁷ Së fundi, ajo parashtrohet se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë fazë është e përligjur, sepse, në qoftë se janë vlerësuar gabimisht pikat për privatësinë e dëshmitarëve të ZPS-së, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.⁸⁸

59. Mbrojtja e Selimit në thelb argumenton në Pikën e Tretë të Selimit se zbatimi i incizimit dhe nxjerrjes (përkatësisht dorëzimi i një kopjeje Panelit) i tejkalon kompetencat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 39(11) të Ligjit, sepse kjo dispozitë përmban vetëm masa të cilat janë të domosdoshme për *ruajtjen*, por jo për *mbledhjen* e provave. Në këtë aspekt, Mbrojtja e Selimit: (i) parashtrohet se Korniza i kërkon në mënyrë të paligjshme Mbrojtjes të angazhohet në mbledhje provash për llogari të ZPS-së dhe Panelit, përmes mundësisë që incizimet e intervistave të bëhen pjesë e dokumentacionit gjyqësor (nga që i dorëzohen Panelit); dhe (ii) shton se kjo pikë kundërshton “mjaftueshmërinë e garancive

⁸⁵ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

⁸⁶ Kërkesa e Thaçit, para. 6 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 121-123), 10; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 7.

⁸⁷ Kërkesa e Thaçit, para. 12, 15.

⁸⁸ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

gjyqësore”.⁸⁹ Mbrojtja e Selimit argumenton gjithashtu se kjo pikë prek ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit (dhe mbase rezultatin e gjykimit), sepse shpërdorimi (i pretenduar) i diskrecionit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën që: (i) diskrecioni i Mbrojtjes në kryerjen e hetimeve të veta të kufizohet në mënyrë të padrejtë; dhe (ii) Mbrojtjes t’i kërkohet në mënyrë të paligjshme të angazhohet në mbledhje të provave për llogari të ZPS-së dhe Panelit.⁹⁰ Së fundi, Mbrojtja e Selimit argumenton se një ndërhyrje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit do të mund të eliminonte nga procesi gabimet e mundshme dhe t’u jepte atyre drejtimin e duhur.⁹¹

60. ZPS-ja përgjigjet, lidhur me Pikën e Shtatë të Thaçit, se Mbrojtja e Thaçit nuk artikulon në mënyrë të përshtatshme: (i) një pikë të veçantë, zgjidhja e së cilës do të ishte thelbësore për kryerjen e ardhshme të procesit; dhe (ii) se si kjo pikë do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit.⁹² Lidhur me Pikën e Nëntë të Thaçit, ZPS-ja parashtrohet se Mbrojtja e Thaçit: (i) nuk përcakton në mënyrë të përshtatshme se cilat parashtime pretendohet se ka shpërfillur Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose se si ka gabuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake në peshën që u ka dhënë;⁹³ dhe (ii) e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar sepse Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ka marrë në konsideratë parashtimet e Mbrojtjes së Thaçit me hollësi dhe i ka trajtuar shqetësimet e saj.⁹⁴ Lidhur me Pikën e Njëmbëdhjetë të Thaçit, ZPS-ja parashtrohet se e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar sepse Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është mbështetur në privatësinë e dëshmitarëve për të përligjur masat e incizimit dhe nxjerrjes, por për të shpjeguar përse Korniza: (i) kërkon që

⁸⁹ Kërkesa e Selimit, para. 1, 12, 20-21 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 115, 124, 212.II.n.ii. dhe o.); shih edhe Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 7, 11.

⁹⁰ Kërkesa e Selimit, para. 21.

⁹¹ Kërkesa e Selimit, para. 25-28.

⁹² Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 15.

⁹³ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 17.

⁹⁴ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 18 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 22, 79, 147-148).

ZPS-ja të nisë kontaktin me dëshmitarin në listën e saj; dhe (ii) përcakton përfshirjen e mëpasshme të ZPS-së.⁹⁵

61. Lidhur me Pikën e Tretë të Selimit, ZPS-ja përgjigjet se kjo pikë mbështetet në një shtrembërim të Vendimit të Kundërshtuar, sepse ky i fundit: (i) nuk i kërkon Mbrojtjes të mbledhë prova për llogari të ZPS-së ose të Panelit; dhe (ii) shprehimisht parasheh që incizimet e intervistave nuk bëhen automatikisht pjesë e dokumentacionit gjyqësor.⁹⁶ Së fundi, ZPS-ja parashton se argumentet e Mbrojtjes së Selimit se kjo pikë do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit nuk janë të vlefshme për të njëjtat arsye.⁹⁷

62. *Pika e apelueshme.* Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ky vendim ka miratuar tashmë leje për të apeluar tri pika mbi incizimin dhe nxjerrjen.⁹⁸ Lidhur me Pikën e Shtatë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja e Thaçit nuk identifikon një gabim të veçantë në Vendimin e Kundërshtuar, por thjesht nuk pajtohet me përfundimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sa i takon mungesës së detyrimit. Lidhur me Pikën e Nëntë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se Mbrojtja e Thaçit nuk identifikon qartë se cili “konstatim” i Vendimit të Kundërshtuar duhet “shfuqizuar”. Krahës kësaj, në qoftë se Mbrojtja e Thaçit synon t’u referohet paragrafëve 146-154 të Vendimit të Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja e Thaçit nuk identifikon një gabim diskret në arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.⁹⁹ Së fundi, lidhur me Pikën e Njëmbëdhjetë të Thaçit, Gjykatësi i

⁹⁵ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 21 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 121-123).

⁹⁶ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 12-13 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 212.II.o.).

⁹⁷ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 14.

⁹⁸ *Shih më lart*, para. 42 (Pika e Parë e Thaçit), 49 (Pika e Katërt e Selimit dhe Pika e Tetë e Thaçit).

⁹⁹ Duke parë, siç i ka përmbledhur dhe trajtuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake argumentet e Mbrojtjes së Thaçit në paragrafët 147-148 të Vendimit të Kundërshtuar, dhe është shprehur në paragrafin 154 të Vendimit të Kundërshtuar se “Korniza ka përcaktuar shprehimisht se, përveçse në situata të situata të kufizuara që kërkojnë autorizim gjyqësor, çdo informacion që vjen nga intervistat e Mbrojtjes me

Procedurës Paraprake vëren se, ndërsa paragrafët 121-123 të Vendimit të Kundërshtuar japin arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi funksionin e Kornizës në lidhje me privatësinë, paragrafët 137-177 të Vendimit të Kundërshtuar i kushtohen vlerësimit të përputhshmërisë së Kornizës me të drejtën për gjykim të drejtë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, në vend që të identifikojë një gabim të veçantë që rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar, Mbrojtja e Thaçit vetëm sa shpreh mospajtim me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në paragrafët e lartpërmendur të Vendimit të Kundërshtuar.

63. Lidhur me Pikën e Tretë të Selimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, siç është formuluar fillimisht,¹⁰⁰ kjo pikë ka të bëjë me pyetjen nëse masat e incizimit dhe nxjerrjes (përkatësisht dorëzimi i një kopjeje Panelit) janë në përputhje me nenin 39(11) të Ligjit. Mirëpo, Mbrojtja e Selimit më vonë e kufizon këtë pikë duke dhënë vetëm një argument të caktuar. Ajo parashtron se duke lejuar mundësinë që incizimet e intervistave të bëhen pjesë e dokumentacionit, Korniza i kërkon Mbrojtjes të angazhohet në mbledhje të provave për llogari të ZPS-së dhe Panelit, pavarësisht nga fakti se mbledhja e provave (për dallim nga ruajtja e provave) nuk mbulohet nga qëllimet e përmendura në nenin 39(11) të Ligjit.¹⁰¹ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se paragrafi 212.II.o. i Vendimit të Kundërshtuar shprehimisht përcakton se, përveçse në situata të kufizuara që kërkojnë autorizim gjyqësor (dhe përmbushje të kushteve për pranim të provave sipas Rregullores), çdo informacion që vjen nga intervistat e Mbrojtjes me dëshmitarët e përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarë të tjerë të njoftuar nuk bëhet pjesë e dokumentacionit. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja e Selimit jo vetëm që ngre shqetësime hipotetike por edhe e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar, sepse ky i fundit

dëshmitarët e përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarë të tjerë të njoftuar nuk bëhet pjesë e dokumentacionit”.

¹⁰⁰ *Shih* Kërkesën e Selimit, para. 1.

¹⁰¹ *Shih* Kërkesën e Selimit, para. 12, 20.

nuk i kërkon në asnjë mënyrë Mbrojtjes të angazhohet në mbledhje të provave për llogari të ZPS-së dhe Panelit. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se ky vendim ka miratuar tashmë leje për apel për Pikën e Katërt të Selimit sa i takon pajtueshmërisë së paragrafit 212.II.j.iv. dhe n.ii. të Vendimit të Kundërshtuar me nenin 39(11) të Ligjit.¹⁰²

64. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këto katër pika nuk përbëjnë pika të apelueshme dhe, rrjedhimisht, e refuzon lejen për të apeluar Pikën e Shtatë, Pikën e Nëntë dhe Pikën e Njëmbëdhjetë të Thaçit dhe Pikën e Tretë të Selimit.

4. Pika e Dhjetë e Thaçit

65. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, në këtë pikë bëhet pyetja nëse, duke pasur parasysh ngritjen (e pretenduar) të çështjes së privatësisë së dëshmitarëve nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake tërësisht në lidhje me dëshmitarët e ZPS-së, pa iu referuar të drejtave apo pritjeve të dëshmitarëve të Mbrojtjes, të gjitha konstatimet e mbështetura në këtë arsyetim duhen anuluar.¹⁰³ Mbrojtja e Thaçit argumenton gjithashtu se kjo pikë prek ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit sepse ndikon ndjeshëm në të drejtën e z. Thaçi për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe për të ushtruar të drejtat e tij në barazi të plotë (në raport me ZPS-në).¹⁰⁴ Së fundi, argumentet e Mbrojtjes së Thaçit nëse një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit paraqiten në paragrafin 58 më lart.

66. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Thaçit vetëm sa ngre shqetësime teorike ose hipotetike, që nuk mund të përbëjnë një pikë të apelueshme. Në veçanti, ZPS-ja

¹⁰² *Shih më lart*, para. 49.

¹⁰³ Kërkesa e Thaçit, para. 6 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 121-123), 10; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 7.

¹⁰⁴ Kërkesa e Thaçit, para. 12, 15.

parashtron se Mbrojtja e Thaçit nuk identifikon në mënyrë të mjaftueshme se cilat konstatime kërkon të kundërshtojë apo përse zgjidhja e kësaj pike do të ishte thelbësore për vendimet mbi pikat që lindin në çështjen juridike.¹⁰⁵

67. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se paragrafi 116 i Vendimit të Kundërshtuar: (i) thotë qartë se Korniza zbatohet për të gjithë dëshmitarët e njoftuar të kësaj çështjeje gjyqësore dhe për kontaktet e tyre me palët jothirrëse dhe pjesëmarrësit;¹⁰⁶ dhe (ii) shpjegon përse Korniza diskutohet veçanërisht në raport me Mbrojtjen, pra ngaqë Mbrojtja ngre argumente lidhur me kontaktet e saj me dëshmitarët e ZPS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Pika e Dhjetë e Thaçit nuk është pikë e apelueshme sepse, përveçse nuk identifikon në mënyrë të mjaftueshme se cilat konstatime kërkon të kundërshtojë, mbështetet në një shtrembërim të Vendimit të Kundërshtuar dhe rrjedhimisht nuk rrjedh prej tij. Rrjedhimisht, refuzohet leja për të apeluar Pikën e Dhjetë të Thaçit.

5. Pika e Dymbëdhjetë dhe Pika e Trembëdhjetë e Thaçit

68. Mbrojtja e Thaçit parashtron se Pika e Dymbëdhjetë e Thaçit kërkon zgjidhje për ndikimin e miratimit të Kornizës pas vitesh që intervistat e ZPS-së janë kryer pa praninë e Mbrojtjes.¹⁰⁷ Sa i takon Pikës së Trembëdhjetë të Thaçit, Mbrojtja e Thaçit parashtron se kjo pikë rrjedh nga rrëzimi nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake i shqetësimeve të Mbrojtjes se (TFHS-ja dhe) ZPS-ja kanë kryer intervista me dëshmitarë pa praninë e Mbrojtjes, mbi bazën se këto hetime ishin më të gjera se çështja gjyqësore e tanishme, megjithëse nxjerrjet e materialeve nga

¹⁰⁵ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 20.

¹⁰⁶ *Shih edhe* Vendimi i Kundërshtuar, para. 121 (“Gjithashtu, Korniza e Propozuar respekton edhe privatësinë e të gjithë dëshmitarëve të përfshirë në Listën e Dëshmitarëve të ZPS-së dhe të dëshmitarëve të tjerë të njoftuar.”).

¹⁰⁷ Kërkesa e Thaçit, para. 6 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 142-145, dhe disa dispozitave të caktuara të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës), 11; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 8.

ZPS-ja tregojnë hetime të kryera për vetë z. Thaçi.¹⁰⁸ Sa u takon të dyja pikave, Mbrojtja e Thaçit parashtrohet gjithashtu se këto ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, në veçanti sepse miratimi i Kornizës në këtë moment çon në zbatim të pabarabartë midis Mbrojtjes dhe ZPS-së, duke ndikuar ndjeshëm në barazinë mes palëve.¹⁰⁹ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtrohet se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë fazë është e përligjur, sepse nëse Protokolli shkel barazinë mes palëve, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të tanishme të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.¹¹⁰

69. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Dymbëdhjetë e Thaçit nuk rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar sepse Korniza rregullon vetëm kontaktet me dëshmitarët e njoftuar të një pale ose pjesëmarrësi dhe zbatohet njësoj për ta, por jo për hetimet apo intervistat më në përgjithësi.¹¹¹ Lidhur me Pikën e Trembëdhjetë të Thaçit, ZPS-ja parashtrohet se Mbrojtja e Thaçit e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar kur argumenton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i hodhi poshtë shqetësimet e Mbrojtjes vetëm në bazë të faktit se intervistat kishin të bënin me Raportin e Këshillit të Evropës në tërësi. Sipas ZPS-së, Vendimi i Kundërshtuar u referohej hetimeve në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës thjesht për të ilustruar përgjegjësitë e ndryshme të Mbrojtjes dhe të ZPS-së në bazë të kornizës ligjore të DHS-së.¹¹²

70. *Pika e apelueshme.* Lidhur me Pikën e Dymbëdhjetë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se: (i) paragrafi 144 i Vendimit të Kundërshtuar shprehimisht thotë se Korniza “do të zbatohet njësoj për intervistat e ZPS-së me dëshmitarët e Mbrojtjes në rast se Mbrojtja do të vendoste të paraqiste prova në

¹⁰⁸ Kërkesa e Thaçit, para. 6 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 140), 11; *shih edhe* Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 8.

¹⁰⁹ Kërkesa e Thaçit, para. 12, 15.

¹¹⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

¹¹¹ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 22.

¹¹² Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 23 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 140).

gjykim”; dhe (ii) paragrafët 138-145 të Vendimit të Kundërshtuar trajtojnë me hollësi parimin e barazisë mes palëve dhe argumentet e bëra ndër të tjera nga Mbrojtja e Thaçit në këtë aspekt. Kështu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se argumentet e Mbrojtjes së Thaçit: (i) kanë të bëjnë me çështje teorike; (ii) përbëjnë vetëm mospajtim me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake; dhe (iii) e shtrembërojnë Vendimin e Kundërshtuar me pretendimin për “zbatim të vonuar” të Kornizës.¹¹³

71. Lidhur me Pikën e Trembëdhjetë të Thaçit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se paragrafët 140-145 të Vendimit të Kundërshtuar paraqesin me hollësi arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për hedhjen poshtë të argumenteve të Mbrojtjes në këtë aspekt. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në vend që të tregojë një gabim të veçantë në arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe për mënyrën se si kjo do të ndikonte në të drejtat e z. Thaçi, Mbrojtja e Thaçit vetëm sa shpreh mospajtim me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

72. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këto dy pika nuk janë pika të apelueshme dhe, rrjedhimisht, refuzon lejen për të apeluar Pikën e Dymbëdhjetë dhe Pikën e Trembëdhjetë të Thaçit.

6. Pika e Katërmëdhjetë e Thaçit

73. Sipas Mbrojtjes së Thaçit, kjo pikë ngre dyshime në lidhje me bazën e konstatimit që bën Gjykatësi i Procedurës Paraprake në paragrafin 125 të Vendimit të Kundërshtuar se Korniza kontribuon në kryerjen e shpejtë të procesit.¹¹⁴ Mbrojtja e Thaçit parashtrohet se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, në veçanti sepse ndikon ndjeshëm në të drejtat e z. Thaçi për

¹¹³ *Shih* Kërkesën e Thaçit, para. 11.

¹¹⁴ Kërkesa e Thaçit, para. 6, 11; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Thaçit, para. 8.

të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe për t'u gjykuar pa vonesë të panevojshme.¹¹⁵ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit argumenton se ndërhyrja e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë fazë është e përligjur, sepse, në qoftë se Korniza nuk është në përputhje me të drejtat e lartpërmendura, atëherë cenimi që u bëhet hetimeve të tanishme të Mbrojtjes dhe të drejtave të z. Thaçi do të jetë i pariparueshëm.¹¹⁶

74. ZPS-ja përgjigjet se përfundimi i lartpërmendur i arritur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake është vetëm një prej aspekteve të shumta që mbështetin konstatimin e tij për domosdoshmërinë e Kornizës për të rregulluar ndër të tjera trajtimin e informacionit konfidencial dhe kontaktet me dëshmitarët. Kështu, sipas ZPS-së, Mbrojtja e Thaçit nuk shpjegon se si konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake ndikon në përfundimin e përgjithshëm se Korniza është e domosdoshme.¹¹⁷

75. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se paragrafi 125 i Vendimit të Kundërshtuar shpjegon qartë se si, sipas mendimit të tij, Korniza kontribuon në kryerjen e shpejtë të procesit.¹¹⁸ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, në vend që të tregojë një gabim të veçantë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Mbrojtja e Thaçit ngre shqetësime hipotetike dhe teorike dhe vetëm shpreh mospajtim me konstatimin e Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo nuk është pikë e apelueshme dhe, rrjedhimisht, e refuzon lejen për të apeluar Pikën e Katërmbëdhjetë të Thaçit.

¹¹⁵ Kërkesa e Thaçit, para. 12, 16.

¹¹⁶ Kërkesa e Thaçit, para. 18.

¹¹⁷ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 24 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 116-135).

¹¹⁸ Gjegjësisht "përmes konkretizimit të detyrimeve të palëve dhe pjesëmarrësve, përcaktimit të një procedure të parashikueshme dhe të njëtrajtshme që duhet ndjekur dhe sqarimit të roleve dhe përgjegjësive të çdo sektori dhe organi të përfshirë të DHS-së".

7. Pika e Pesëmbëdhjetë e Thaçit

76. Mbrojtja e Thaçit vë në dyshim nëse ndikimi i Kornizës në të drejtën e z. Thaçi për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, në pajtim me nenin 21(4)(c) të Ligjit, mund të konsiderohet si i zvogëluar nëpërmjet masave të tilla si intervistat e përbashkëta të Mbrojtjes me dëshmitarët e ZPS-së ose intervistat në distancë të dëshmitarëve të ZPS-së, kur (siç pretendohet) nuk merren në konsideratë kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj këtyre masave.¹¹⁹ Argumentet e Mbrojtjes së Thaçit nëse kjo pikë do të prekte ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit dhe nëse një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit paraqiten në paragrafin 73 më lart.

77. ZPS-ja përgjigjet se duke pretenduar (gabimisht) se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka marrë në konsideratë disa kundërshtime (të papërcaktuara) të Mbrojtjes, Mbrojtja e Thaçit shpreh thjesht mospajtim me përfundimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹²⁰

78. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se paragrafët 171-176 të Vendimit të Kundërshtuar diskutojnë me hollësi të drejtën e të Akuzuarve për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe trajtojnë shprehimisht shqetësimet e ngritura nga Mbrojtja (përfshirë shqetësimet për vështirësitë logjistike). Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja e Thaçit nuk tregon një gabim të veçantë në Vendimin e Kundërshtuar, por vetëm sa shpreh mospajtim me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Kështu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo nuk është pikë e

¹¹⁹ Kërkesa e Thaçit, para. 6 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 175), 11; shih edhe Kundërpërgjigja e Thaçit, para. 8.

¹²⁰ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Thaçit, para. 25 (ku i referohet ndër të tjera Vendimit të Kundërshtuar, para. 172, 175).

apelueshme dhe, rrjedhimisht, e refuzon lejen për të apeluar Pikën e Pesëmbëdhjetë të Thaçit.

8. Pika e Dytë e Selimit

79. Mbrojtja e Selimit parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë gabim faktik me shprehjen se garancitë që siguron Korniza “do të mbulojnë vetëm ata të cilët vetë dëshirojnë ta përdorin” dhe me përcaktimin se preferenca e dëshmitarit dhe shqyrtimit gjyqësor i saj është një garanci kompensuese mbi fushëveprimin e Kornizës, por në të vërtetë çdo intervistë me të gjithë dëshmitarët në fjalë duhet të bëhet në bazë të Kornizës.¹²¹ Mbrojtja e Selimit parashtron gjithashtu se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse një kuptim i mangët ose i pasaktë i garancive kompensuese nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën që Korniza të jetë me fushëveprim të gjerë në mënyrë të padrejtë. Sipas Mbrojtjes së Selimit, kjo bën që: (i) Mbrojtjes t’i ndalohet në mënyrë të paligjshme që të intervistojë potencialisht ndonjë prej dëshmitarëve në fjalë jashtë Kornizës; (ii) përmbajtja e këtyre intervistave potencialisht të kufizohet në mënyrë të padrejtë; dhe (iii) hetimet e Mbrojtjes të vonohen në mënyrë të panevojshme.¹²² Së fundi, Mbrojtja e Selimit argumenton se një ndërhyrje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të eliminonte nga procesi gabimet e mundshme dhe t’u jepte atyre drejtimin e duhur.¹²³

80. ZPS-ja përgjigjet se kjo pikë e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar, në veçanti ngaqë fjalja në paragrafin 119 të Vendimit të Kundërshtuar, e cituar nga Mbrojtja e Selimit, qartësisht u referohet vetëm garancive të Kornizës, të cilat dëshmitarët mund të vendosin t’i përdorin. ZPS-ja shton se Mbrojtja e Selimit nuk

¹²¹ Kërkesa e Selimit, para. 1, 11, 18 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 119-120); shih edhe Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 6.

¹²² Kërkesa e Selimit, para. 19.

¹²³ Kërkesa e Selimit, para. 25-28.

tregon përse ky konstatim do të ishte faktikisht i pasaktë.¹²⁴ Së fundi, ZPS-ja parashtron se argumentet e Mbrojtjes së Selimit lidhur me ndikimin e kësaj pike në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit janë të pabaza.¹²⁵

81. *Pika e apelueshme*. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, siç duket qartë nga struktura dhe nëntitujt e Vendimit të Kundërshtuar (“(a) Funkcionet e Kornizës së Propozuar”; “(i) Mbrojtja”), paragrafi 119 i Vendimit të Kundërshtuar ka të bëjë me funksionin mbrojtës të Kornizës. Fokusi i paragrafëve 116-120 është qartë procedura për kontaktet midis dëshmitarëve dhe palës kundërshtare ose pjesëmarrësit, në veçanti ndihma dhe mbrojtja që dëshmitarët mund të kërkojnë kur një palë kundërshtare ose pjesëmarrës dëshiron t’i intervistojë.¹²⁶ Si e tillë, fjalia e cituar nga Mbrojtja e Selimit ka të bëjë qartë me paragrafin 212.II.b. të Vendimit të Kundërshtuar, ku përcaktohet procedura për marrjen e pëlqimit të dëshmitarit për t’u intervistuar. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Selimit: (i) e nxjerr nga konteksti fjalinë e cituar, duke e shtrembëruar Vendimin e Kundërshtuar; dhe (ii) nuk identifikon ndonjë gabim në arsyetimin e Vendimit të Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo nuk është pikë e apelueshme dhe, rrjedhimisht, e refuzon lejen për të apeluar Pikën e Dytë të Selimit.

9. Pika e Parë dhe Pika e Dytë e Krasniqit

82. Në Pikën e Parë të Krasniqit, Mbrojtja e Krasniqit vë në dyshim nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka zbatuar standardin e domosdoshmërisë lidhur me masat e Kornizës, siç kërkohet në nenet 35(2)(f) dhe 39(1) dhe (11) të Ligjit.¹²⁷ Lidhur me Pikën e Dytë të Krasniqit, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se, për aq

¹²⁴ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 7-8.

¹²⁵ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Selimit, para. 10.

¹²⁶ *Shih, në veçanti*, Vendimin e Kundërshtuar, para. 116 *ab initio*.

¹²⁷ Kërkesa e Krasniqit, para. 2, 16; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 5.

sa ka zbatuar standardin e domosdoshmërisë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka bërë gabim faktik dhe juridik me konstatimin se Korniza ishte e domosdoshme.¹²⁸ Mbrojtja e Krasniqit argumenton gjithashtu se këto dy pika ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, sepse Korniza vendos kufizime mbi mundësinë e Mbrojtjes për të kontaktuar dëshmitarët dhe u kërkon ekipeve të Mbrojtjes të bëjnë hapa shtesë.¹²⁹ Së fundi, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se një zgjidhje e menjëhershme e këtyre dy pikave nga Paneli i Gjykatës së Apelit do të kontribuonte thelbësisht në avancimin e procesit, sepse një Kornizë e vendosur në mënyrë të padrejtë do t'i kufizojë padrejtësisht hetimet e ardhshme të Mbrojtjes dhe do ta njollosë drejtësinë e procesit.¹³⁰

83. ZPS-ja përgjigjet se Pika e Parë e Krasniqit shpërfill dhe shtrembëron konstatimet përkatëse të Vendimit të Kundërshtuar, në veçanti ngaqë Vendimi i Kundërshtuar tregon se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte qartë në dijeni të kriterit të domosdoshmërisë dhe ngaqë ka dhënë arsyet përse e konsideronte të domosdoshëm miratimin e Kornizës.¹³¹ Lidhur me Pikën e Dytë të Krasniqit, ZPS-ja përgjigjet se: (i) kjo pikë nuk është konkrete apo e veçantë në mënyrë të mjaftueshme; (ii) Mbrojtja e Krasniqit nuk saktëson gabimin e pretenduar; dhe (iii) kjo pikë përbën thjesht mospajtim me përfundimet e përgjithshme të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹³²

84. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, ndër të tjera, Pika e Pestë e Krasniqit, për të cilën është dhënë leja për apel,¹³³ i mbulon tashmë temat e bazës ligjore dhe domosdoshmërisë së Kornizës. Gjithashtu, Gjykatësi i

¹²⁸ Kërkesa e Krasniqit, para. 2, 19; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 6.

¹²⁹ Kërkesa e Krasniqit, para. 17, 20.

¹³⁰ Kërkesa e Krasniqit, para. 18, 20.

¹³¹ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 2 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 115, 117-118, 198).

¹³² Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 3-4, 6.

¹³³ *Shih më lart*, para. 22.

Procedurës Paraprake konstaton se, në bazë të formulimit dhe mbështetjes me terma të përgjithshme të tyre, Pika e Parë dhe Pika e Dytë e Krasniqit nuk identifikojnë në mënyrë të papërshtatshme një gabim të veçantë që rrjedh nga Vendimi, por përbëjnë thjesht mospajtim me konstatimet e Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi domosdoshmërinë e masave të Kornizës. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk janë pika të apelueshme dhe, rrjedhimisht, refuzon lejen për të apeluar Pikën e Parë dhe Pikën e Dytë të Krasniqit.

10. Pika e Katërt e Krasniqit

85. Mbrojtja e Krasniqit ka kundërshtim për një fjali të veçantë në paragrafin 170 të Vendimit të Kundërshtuar,¹³⁴ duke pretenduar një gabim nga ana e Gjykatës të Procedurës Paraprake në kuptimin që nuk ka bërë dallimin midis të Akuzuarve dhe mbrojtësve. Sipas Mbrojtjes së Krasniqit, kjo pikë është thelbësore për Vendimin e Kundërshtuar sepse kundërshton relevancën e konstatimeve të përgjithshme për atmosferën e frikësimit dhe ndikimit të të Akuzuarve, në të cilat (siç pretendohet) mbështetet Vendimi i Kundërshtuar për zbatimin e masave për kontaktin e mbrojtësve me dëshmitarët.¹³⁵ Mbrojtja e Krasniqit argumenton gjithashtu se kjo pikë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit sepse ndikon në parimin e barazisë mes palëve dhe në të drejtën e z. Krasniqi për të pasur mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes (e mishëruar në nenin 21(4)(c) të Ligjit).¹³⁶ Së fundi, krahas arsyeve të paraqitura në paragrafin 82 më lart, Mbrojtja e Krasniqit argumenton se një zgjidhje e menjëhershme e kësaj

¹³⁴ “Duke pasur parasysh se të Akuzuarit i ushtrojnë të drejtat për mbrojtje nëpërmjet mbrojtësve, Korniza e Propozuar duhet medoemos të sigurojë që mbrojtësit të veprojnë në përputhje me konstatimet e lartpërmendura lidhur me rreziqet me të cilat përballen individë të caktuar dhe atmosferën e frikësimit”.

¹³⁵ Kërkesa e Krasniqit, para. 23 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 118, 124, 169-170, 173, 198); shih edhe Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 7.

¹³⁶ Kërkesa e Krasniqit, para. 24 (ku i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 142-143, 151, 159, 170).

pike nga Paneli i Gjykatës së Apelit do të kontribuojë thelbësisht në avancimin e procesit duke ruajtur barazinë mes palëve dhe duke përcaktuar kufij të përshtatshëm për mbrojtësit në përgatitjen e qasjes së tyre strategjike për çështjen gjyqësore.¹³⁷

86. ZPS-ja përgjigjet se kjo nuk është pikë e apelueshme sepse Mbrojtja e Krasniqit nuk identifikon një pikë precize por bashkon disa pika ose madje e kundërshton Vendimin e Kundërshtuar në tërësi.¹³⁸ ZPS-ja parashtron gjithashtu se Mbrojtja e Krasniqit: (i) e shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar; (ii) nuk jep asnjë bazë ligjore për pretendimin se të drejtat për gjykim të drejtë do të ndikoheshin nga Korniza; dhe (iii) nuk tregon kështu se pika do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatin e gjykimit.¹³⁹

87. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se menjëherë pas fjalisë së cituar nga Mbrojtja e Krasniqit, Vendimi i Kundërshtuar thotë se kjo nuk nënkupton apo nuk prezumon se mbrojtësit janë përfshirë apo do të përfshiheshin në frikësim të dëshmitarëve apo në ndërhyrje në procedura në mungesë të një indikacioni për të kundërtën.¹⁴⁰ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Mbrojtja e Krasniqit e nxjerr jashtë kontekstit fjalinë e cituar, duke e shtrembëruar kështu Vendimin e Kundërshtuar. Krahas kësaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Mbrojtja e Krasniqit nuk identifikon ndonjë gabim konkret. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo nuk është pikë e apelueshme dhe, rrjedhimisht, refuzon lejen për të apeluar Pikën e Katërt të Krasniqit.

¹³⁷ Kërkesa e Krasniqit, para. 18, 25.

¹³⁸ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 12-13.

¹³⁹ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Krasniqit, para. 14-17.

¹⁴⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 170 *in fine*.

11. Pika e Dytë e Veselit

88. Mbrojtja e Veselit parashtrohet se kjo pikë: (i) rrjedh nga paragrafët 137-177 të Vendimit të Kundërshtuar; dhe (ii) ka të bëjë me përputhshmërinë e Kornizës me të drejtën e z. Veseli për gjykim të drejtë, si e drejta e barazisë mes palëve, që do të shkelej nëse Mbrojtjes do t'i mohohet e njëjta "liri në përzgjedhjen e metodikës së kontaktimit dhe intervistimit të dëshmitarëve [...]".¹⁴¹ Krahas kësaj, Mbrojtja e Veselit kundërshton domosdoshmërinë e Kornizës.¹⁴² Mbrojtja e Veselit argumenton gjithashtu se kjo pikë ndikon drejtpërdrejt në rezultatin e procesit sepse mund shkelë të drejtën e z. Veseli për gjykim të drejtë.¹⁴³ Së fundi, Mbrojtja e Veselit argumenton se një vendim nga Paneli i Gjykatës së Apelit në këtë fazë është i justifikuar sepse do të shmangte rrezikun e cenimit që mund t'i shkaktohet zotit Veseli dhe do të sigurote qartësi në lidhje me bazën ligjore të Kornizës.¹⁴⁴

89. ZPS-ja përgjigjet se kjo pikë nuk është e veçantë në mënyrë të mjaftueshme, ngaqë kundërshton përputhshmërinë e Kornizës me të drejtat për gjykim të drejtë, duke kundërshtuar kështu 41 paragrafë të Vendimit të Kundërshtuar pa identifikuar siç duhet konstatime konkrete.¹⁴⁵ Krahas kësaj, ZPS-ja parashtrohet se me shembujt e gabimeve të pretenduara, Mbrojtja e Veselit: (i) thjesht sa përsërit parashtrimet që ka bërë më parë; (ii) vetëm sa shpreh mospajtim me konstatimet përkatëse të Gjykatës të Procedurës Paraprake; dhe (iii) shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar kur pretendon se këto parashtrime nuk janë trajtuar apo se pikat përkatëse nuk kanë marrë ende përgjigje.¹⁴⁶ Gjithashtu, ZPS-ja parashtrohet se Mbrojtja e Veselit nuk përcakton se cilat të drejta për gjykim të drejtë (dhe si) do të kufizoheshin në mënyrë të panevojshme dhe/ose joproporcionale nga

¹⁴¹ Kërkesa e Veselit, para. 2, 9 (ku i referohet ndër të tjera Vendimit të Kundërshtuar, para. 140).

¹⁴² Kërkesa e Veselit, para. 10 (ku i referohet ndër të tjera Vendimit të Kundërshtuar, para. 120, 130).

¹⁴³ Kërkesa e Veselit, para. 12 (dhe referenca në të).

¹⁴⁴ Kërkesa e Veselit, para. 13.

¹⁴⁵ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 6.

¹⁴⁶ Përgjigja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 7.

Korniza.¹⁴⁷ Së fundi, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja e Veselit nuk e përmbush detyrimin në lidhje me pyetjen nëse kjo pikë do të prekte ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatin e gjykimit dhe nëse një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuonte thelbësisht në avancimin e procesit.¹⁴⁸

90. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo pikë është formuluar në mënyrë shumë të përgjithshme (“nëse Korniza shkel të drejtën e të Akuzuarve për gjykim të drejtë”) dhe nuk është e specifikuar mjaftueshëm më tej në parashtrimin (ose parashtrimet) e Mbrojtjes së Veselit.¹⁴⁹ Në veçanti, Mbrojtja e Veselit nuk jep bazë (përpos që përmend parimin e barazisë mes palëve) se cilat të drejta për gjykim të drejtë, dhe në cilën mënyrë, do të shkeleshin nga Korniza. Duke vërejtur se ky vendim ka miratuar tashmë leje për apel për Pikën e Gjashtë të Krasniqit,¹⁵⁰ që gjithashtu ka të bëjë me drejtat për gjykim të drejtë por është më konkrete, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se Pika e Dytë e Veselit nuk përbën pikë të apelueshme dhe, rrjedhimisht, refuzon leje për ta apeluar.

12. Pika e Tretë e Veselit

91. Mbrojtja e Veselit argumenton se: (i) kjo pikë rrjedh ndër të tjera nga paragrafi 131 i Vendimit të Kundërshtuar;¹⁵¹ dhe (ii) Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme përse të Akuzuarit në këtë çështje gjyqësore duhet të trajtohen ndryshe nga të akuzuar të tjerë në raste thelbësisht të ngjashme në mos identike (për shembull në KSC-BC-2020-04 dhe

¹⁴⁷ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 8.

¹⁴⁸ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 12-13.

¹⁴⁹ *Shih edhe* Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 6-8, që mbeten të përgjithshme.

¹⁵⁰ *Shih më lart*, para. 28.

¹⁵¹ Ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se “qasjet e ndjekura në procedurat e tjera të DHS-së dhe/ose tribunalët e tjerë janë specifike për situatat e trajtuara nga këta tribunalë dhe nuk e shfuqizojnë në vetvete përfundimin se korniza ligjore e DHS-së e lejon miratimin e një kornize të tillë”.

KSC-BC-2020-05).¹⁵² Argumentet e Mbrojtjes së Veselit nëse kjo pikë do të prekte ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit dhe nëse një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuonte thelbësisht në avancimin e procesit paraqiten në paragrafin 88 më lart.

92. ZPS-ja përgjigjet se: (i) kjo pikë nuk rrjedh nga Vendimi i Kundërshtuar, sepse nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkohej të shqyrtonte bazën ligjore dhe përshtatshmërinë e Kornizës vetëm në raport me këtë çështje gjyqësore; (ii) jo vetëm që do të kishte qenë jorelevante por madje edhe e papërshtatshme nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake do ta shqyrtonte zbatueshmërinë ose relevancën e Kornizës në raport me çështje të tjera gjyqësore para DHS-së; dhe (iii) Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka arsyetuar në mënyrë të kujdesshme përse e ka konsideruar Kornizën të domosdoshme në këtë çështje gjyqësore.¹⁵³ Së fundi, ZPS-ja argumenton se Mbrojtja e Veselit nuk e përmbush detyrimin e saj në lidhje me nëse kjo pikë do të prekte ndjeshëm kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit dhe nëse një zgjidhje e menjëhershme nga Paneli i Gjykatës së Apelit mund të kontribuonte thelbësisht në avancimin e procesit.¹⁵⁴

93. *Pika e apelueshme.* Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se: (i) paragrafi 131 i Vendimit të Kundërshtuar i trajton shqetësimet e paraqitura nga Mbrojtja e Veselit; dhe (ii) Mbrojtja e Veselit nuk identifikon një gabim konkret, por vetëm sa shpreh mospajtim me konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në këtë aspekt. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kjo pikë nuk është pikë e apelueshme dhe, rrjedhimisht, e refuzon lejen për të apeluar Pikën e Tretë të Veselit.

¹⁵² Kërkesa e Veselit, para. 2, 11; *shih edhe* Kundërpërgjigjen e Veselit, para. 9.

¹⁵³ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 10-11 (*ku i referohet* Vendimit të Kundërshtuar, para. 118).

¹⁵⁴ Përgjigjja e ZPS-së ndaj Kërkesës së Veselit, para. 12-13.

V. VENDIM

94. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** lejen për të apeluar: (i) Pikën e Parë, Pikën e Dytë, Pikën e Katërt dhe Pikën e Tetë të Thaçit; (ii) Pikën e Parë dhe Pikën e Katërt të Selimit; (iii) Pikën e Tretë, Pikën e Pestë dhe Pikën e Gjashtë të Krasniqit; dhe (iv) Pikën e Parë të Veselit; dhe
- b. **REFUZON** lejen për të apeluar: (i) Pikën e Tretë, Pikën e Pestë, Pikën e Gjashtë, Pikën e Shtatë, Pikën e Nëntë, Pikën e Dhjetë, Pikën e Njëmbëdhjetë, Pikën e Dymbëdhjetë, Pikën e Trembëdhjetë, Pikën e Katërmëdhjetë dhe Pikën e Pesëmbëdhjetë të Thaçit; (ii) Pikën e Dytë dhe Pikën e Tretë të Selimit; (iii) Pikën e Parë, Pikën e Dytë dhe Pikën e Katërt të Krasniqit; dhe (iv) Pikën e Dytë dhe Pikën e Tretë të Veselit.

 /nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 26 gusht 2022

Hagë, Holandë.